



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 4184 / prot.

Tiranë, më 28.7.2021

UDHËZIM

Nr. 14, datë 28.7.2021

PËR

DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 30, DATË 12.9.2018 "PËR NUMRIN E NXËNËSVE PËR KLASË DHE NORMAT E PUNËS MËSIMORE NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës "d", të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 30, datë 12.9.2018, i ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si vijon:

a) Germat "a" dhe "b" të pikës 2, të Seksionit A, të Kreut II, ndryshohen, si vijon:

- "a) Dy klasa paralele, kur numri i nxënësve është 30-59;*
- b) Tri klasa paralele, kur numri i nxënësve është 60-99;"*

b) Pika 4, e Seksionit A, e Kreut II, ndryshohet, si vijon:

"4. Numri i punonjësve mësimorë në arsimin fillor të llogaritet një mësues për çdo klasë. Lëndët e "TIK", "Gjuhë e Huaj" dhe "Edukim fizik, sporti dhe shëndeti" (1 orë), do zhvillohen nga punonjësit mësimorë të arsimit të mesëm të ulët, sipas profilit përkatës."

c) Pas pikës 4, të Seksionit A, të Kreut II, shtohet pika 5 me përmbajtje, si vijon:

"5. Në shkollat speciale klasat formohen me jo më pak se 6 nxënës."

d) Pas germës "d" të pikës 2, të Seksionit B, të Kreut II, shtohet germa "e", me përmbajtje, si vijon:

"e) Në klasat kolektive kur ka më shumë se 10 nxënës mësimi zhvillohet i ndarë vetëm për lëndët "Gjuhë Shqipe", "Gjuhë e Huaj" dhe "Matematikë"."

e) Pikat 2 dhe 3 të Seksionit C, të kreut II, ndryshohen si vijon:

2. Kur numri i nxënësve është 200–480, emërohet një nëndrejtor shkolle.
3. Kur numri i nxënësve është 481–900, emërohen dy nëndrejtorë shkolle.”.

f) Pikat 6, 7, 8, 9 dhe 10 të Seksionit D, të kreut II, ndryshohen si vijon:

- | | |
|---|------------------|
| “6. Drejtori i shkollës me 81–300 nxënës: | 6 orë në javë. |
| 7. Drejtori i shkollës me 301–600 nxënës: | 4 orë në javë. |
| 8. Drejtori i shkollës me 601–900 nxënës: | 2 orë në javë. |
| 9. Drejtori i shkollës mbi 900 nxënës: | 0-2 orë në javë |
| 10. Nëndrejtori i shkollës: | 6 orë në javë.”. |

g) Pika 1 e Seksionit A, të kreut III, ndryshohet si vijon:

“1. Klasat në zonat urbane të formohen me jo më pak se 25 nxënës dhe në zonat rurale me jo më pak se 10 nxënës.”.

h) Pikat 1 dhe 2 të Seksionit B, të kreut III, ndryshohen si vijon:

1. Kur numri i nxënësve është 200–480, emërohet një nëndrejtor shkolle.
2. Kur numri i nxënësve është 481–900, emërohen dy nëndrejtorë shkolle.”

i) Pikat 4, 5, 6, 7 dhe 8, të Seksionit C, të kreut III, ndryshohen si vijon:

- | | |
|---|------------------|
| “4. Drejtori i shkollës me 81–300 nxënës: | 6 orë në javë. |
| 5. Drejtori i shkollës me 301–600 nxënës: | 4 orë në javë. |
| 6. Drejtori i shkollës me 601–900 nxënës: | 2 orë në javë. |
| 7. Drejtori i shkollës mbi 900 nxënës: | 0-2 orë në javë. |
| 8. Nëndrejtori i shkollës: | 6 orë në javë.”. |

j) Pika 10 e kreut V ndryshohet si vijon:

“10. Mësuesi që drejton bibliotekën e shkollës i llogariten:

- a) 2 orë në javë, kur shkolla ka bibliotekë dhe ka deri në 300 nxënës.
- b) 3 orë në javë, kur shkolla ka bibliotekë dhe ka mbi 301–600 nxënës.
- c) 4 orë në javë, kur shkolla ka bibliotekë dhe ka mbi 600 nxënës.”.

k) Pika 22 e kreut V ndryshohet si vijon:

“ 22. Mësuesi mentor, për mentorimin e një praktikanti, i ulet norma me 2 orë në javë. Një mësues mentoron 1-2 praktikantë.”.

l) Pas pikës 24, shtohen pikat 25 dhe 26 me përmbajtje si më poshtë:

“25. Si rregull, mësuesit, të cilëve u është ulur norma për kryerjen e veprimtarive të ndryshme të përcaktuara në këtë udhëzim, nuk mund të ngarkohen me orë shtesë të pagueshme, përveç rasteve kur shkolla, në bashkëpunim me Zyrën Vendore Arsimore, nuk mund t'i mbulojë ato orë me mësues të tjerë.

26. Në shkollën koreografike mësuesit e specialitetit balet e kanë ngarkesën 20 orë në javë.”

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Evis KUSHI

